

RELACION
PËR
PROJEKTLIGJIN

**“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPEVE VENDORE
TË VEPRIMIT”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN
TË ARRIHEN**

Ky ligj ka për qëllim zbatimin e qasjes së BE-së për zhvillimin rural me pjesëmarrje (qasja LEADER) nëpërmjet përcaktimit të parakushteve, për krijimin dhe funksionimin e Grupeve Vendore të Veprimit(GVV) të cilët do të mundësojnë, përmes partneritetit lokal dhe metodës nga poshtë-lart, përfshirjen e komuniteteve lokale në identifikimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit të udhëhequra nga komuniteti në varësi të nevojave të tyre, marrjen e vendimeve për alokimin e burimeve të tyre financiare, dhe menaxhimin e tyre bazuar në zhvillimin e qëndrueshëm.

Gjithashtu ky ligj përcakton parimet bazë, standardet, përgjegjësitë, dhe proceset për organizimin dhe funksionimin e Grupeve Vendore të Veprimit, dhe hartimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit të udhëhequra nga komuniteti, në harmoni me Politikën e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural.

Me miratimin e këtij projektligji, përcaktohet baza për krijimin e GVV-ve dhe fillimin e zbatimit të programit të BE-së IPARD II, për mbështetjen e GVV-ve dhe financimin e Strategjive Lokale të Zhvillimit.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektligj është në përputhje dhe në zbatim të Programit Politik të Qeverisë në fushën e zhvillimit rural dhe Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor miratuar me VKM Nr.709, datë 29.10.2014. Projektligji nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Akteve që do të miratohen nga Këshilli i Ministrave për vitin 2018, por miratimi i tij është i rëndësishëm në kuadrin e implementimit të programit për zhvillimin rural të financuar nga BE-ja, IPARD II.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Krijimi i Grupeve Vendore të Veprimit do të mundësojnë, përmes partneritetit lokal dhe metodës nga poshtë-lart, përfshirjen e komuniteteve lokale në identifikimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit të udhëhequra nga komuniteti në varësi të nevojave të tyre dhe marrjen e vendimeve për alokimin e burimeve të tyre financiare, gjithashtu do të mundësojë edhe menaxhimin e tyre, bazuar në zhvillimin e qëndrueshëm.

Nëpërmjet këtij ligji do të përcaktohen parimet, kriteret, përgjegjësitë, organizimi dhe funksionimi i këtyre grupeve vendore të veprimit, të cilat krijohen nga aktorët e përcaktuar në këtë ligj dhe vetëm në një zonë LEADER, sipas kufijve të përcaktuar, që duhet të jenë të vazhdueshëm gjeografikisht dhe të mbulojnë një territor rural me popullsi 10 000 - 150 000 banorë.

Ky ligj vendos edhe kuadrin rregullator për funksionimin e GVV-ve me pjesëmarrjen e njësisive të vetëqeverisjes vendore dhe aktorëve të tjerë lokal, duke lejuar aktivizimin e burimeve dhe institucioneve vendore për një zhvillim rural të qëndrueshëm dhe me pjesëmarrje, si dhe duke mbyllur hapësirat për abuzime nga shoqata apo projekte të cilat nuk respektojnë parimet dhe kriteret e përcaktuara.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin vendas si dhe me legjislacionin e BE-së (EU Regulation 1305/2013 dhe EU Regulation 1303/2013).

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Legjislacioni evropian në lidhje me menaxhimin e fondeve strukturore, përfshirë atë për zhvillimin rural, ku parashikohet edhe mbështetja për GVV, nuk është subjekt transpozimi në legjislacionin vendas, por ndërkohë parimet dhe rregullat e parashikuara në të duhen zbatuar në mënyrë analoge dhe të përputhur në sistemin vendas të menaxhimit të fondeve të parashikuara për mbështetjen e GVV. Në këtë kontekst, ky projektligj transponon pjesën pëkatëse të Rregullores së BE 1305/2013 dhe Rregullores 1303/2013, si dhe parimet e

këtyre Rregulloreve, e specifikuar edhe në tabelën e përputhshmërisë, bashkëlidhur këtij relacioni.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar me katër krerë dhe i përbërë nga 18 nene, me përmbajtje si më poshtë:

Në nenin 1 qëllimi, përcaktohen parakushtet për krijimin dhe funksionimin e Grupeve Vendore të Veprimit (GVV) të cilët do të mundësojnë, përmes partneritetit lokal dhe metodës nga poshtë-lart, përfshirjen e komuniteteve lokale në identifikimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit të udhëhequra nga komuniteti dhe marrjen e vendimeve për alokimin e burimeve të tyre financiare si dhe menaxhimin e tyre bazuar në zhvillimin e qëndrueshëm.

Në nenin 2 fusha e veprimit, përcaktohen parimet bazë, standardet, përgjegjësitë dhe proceset për organizimin dhe funksionimin e GVV-ve, si dhe hartimi dhe zbatimi strategjive të zhvillimit të udhëhequra nga komuniteti, në harmoni me Politikën e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural.

Në nenin 3 përkufizimet, jepen përkufizimet e të gjithë termave të përdorura në kuptim të këtij ligji.

Në nenin 4 parimi i partneritetit, përcaktohet se GVV-të janë shprehje e një partneriteti lokal të gjerë dhe përfaqësues dhe përfshin:

- të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucione të tjera publike;
- përfaqësuesit përkatës të sektorit privat fermer dhe jo fermer;
- organizata që përfaqësojnë shoqërinë civile, të tilla.

Gjithashtu përcaktohet se asnjë autoritet publik ose grup interesi (nga sektori privat ose shoqëria civile) nuk mund të përfaqësojë më shumë se 49% të të drejtave të votës në nivelin më të lartë të vendimmarrjes së GVV-ve sipas ligjit.

Në nenin 5 parimi territorial, përcaktohet se zona LEADER duhet të ketë qartësisht të dallueshëm dhe qëndrueshëm koherencën fizike/territoriale, sociale dhe ekonomike, për të arritur objektivat e saj. Aktorët lokalë mund të themelojnë një GVV vetëm në një zonë LEADER, duke përcaktuar kufijtë më të përshtatshëm, të cilët duhet të jenë të vazhdueshëm gjeografikisht, të mbulojnë një territor rural me popullsi 10 000-150 000 banorë dhe kufijtë administrativë të bashkisë, sipas legjislacionit në fuqi, nuk kanë rol kufizues në përcaktimin e kufijve të kësaj zone.

Në nenin 6 parimi nga poshtë-lart, përcaktohet se sipas këtij parimi aktorët lokalë marrin pjesë në vendimmarrjen mbi strategjinë dhe prioritetet e zgjedhura që do të ndiqen në zonën e tyre, ku përfshihet edhe popullsia në masë, grupet e interesave ekonomike dhe sociale, si dhe përfaqësuesit e institucioneve publike dhe private. GVV për të aplikuar parimin nga poshtë-lart, do të përfshijnë aktorët lokalë në përgatitjen, zbatimin dhe vlerësimin e strategjive të zhvillimit lokal të udhëhequra nga komuniteti.

Në nenin 7 parimi rrjetëzimit dhe bashkëpunimit, përcaktohet se sipas këtij parimi GVV do të lejohen dhe inkurajohen të promovojnë aktivitetet në rrjet dhe projektet e bashkëpunimit me qëllim tejkalimin e izolimit të zonave rurale dhe fuqizimin e kapaciteteve të aktorëve lokalë të zonave LEADER, për të ndjekur objektivat e tyre zhvilluese, përmes shkëmbimeve dhe bashkëpunimit konkret me territore të tjera.

Neni 8, përcakton fushën e veprimit të GVV-ve që është mbështetja e rritjes ekonomike, sociale dhe kulturore të komuniteteve të zonës LEADER, përmes rritjes së vlerave të burimeve lokale dhe aseteve si dhe përmes hartimit e zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit Lokal të Udhëhequr nga Komuniteti, duke përcaktuar llojet e ndryshme të aktiviteteve që mund të promovojë GVV-ja.

Neni 9, përcakton se GVV-të krijohen dhe funksionojnë si organizatë jo-fitimprurëse sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8788/2001 “Mbi organizatat jo-fitimprurëse”. Ky nen përcakton edhe strukturën e brendshme që përbëhet nga:

- Asamblea e Përgjithshme;
- Presidenti;
- Bordi;
- stafi, që do të përfshijë të paktën, Drejtorin Ekzekutiv dhe Kontabilistin (që mund të jetë ekspert i jashtëm) si dhe organizimin e secilit prej tyre.

Neni 10, përcakton funksionet e GVV-ve, të cilët gjatë zbatimit të strategjisë së zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti, duhet të jetë në gjendje të kryejnë këto funksione:

- të krijojë kapacitetet e aktorëve lokale;
- të hartojë një procedurë seleksionimi jo-diskriminuese dhe transparente dhe të përcaktojë kritere objektive për seleksionimin e projekteve;
- të sigurojë koherencë me strategjinë e zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti kur seleksionon projektet;
- të përgatisë dhe publikojë kërkesa për propozime ose një procedurë të vazhdueshme të paraqitjes së projekteve;
- të marrë dhe vlerësojë aplikimet për mbështetje;
- të përzgjedhë projektet dhe të përcaktojë masën e mbështetjes;

- të monitorojë dhe zbatoje strategji të zhvillimit lokal të udhëhequra nga komuniteti dhe projektet e mbështetura;
- të vitalizojë strategjinë e zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti për të mundësuar shkëmbime mes aktorëve për sigurimin e informacionit dhe promovimin e strategjisë, dhe të mbështesë përfituesit potencialë duke synuar zhvillimin e projekteve dhe përgatitjen e aplikimeve.

Neni 11, përcakton organizimin e GVV-ve, që gjatë realizimit të misionit të tij publik, kryhen aktivitete në përputhje me parimet e një prokurimi publik efektiv, transparent dhe llogaridhënës si dhe me parimet e menaxhimit të qëndrueshëm financiar, sipas ligjit nr.10296/2010 “Mbi menaxhimin dhe kontrollin financiar”. Por pa rënë ndesh me kërkesat e ligjit të sipërpërmendur, Asambleja e Përgjithshme e GVV-ve duhet të miratojë një rregullore të brendshme për procedurat e funksionimit të GVV-ve.

Neni 12, përcakton se instrumentet financiare, për financimin e GVV-ve miratohen nga Asambleja e Përgjithshme dhe përfshijnë:

- tarifën e anëtarësisë;
- grante;
- kredi;
- skema garancie;
- pjesëmarrje me aksione (në para/në natyrë);
- partneritete publik-privat.

Neni 13, përcakton konfliktin e interesit, që ka potencialin të çenojë paanësinë për shkak të konfliktit të mundshëm ndërmjet interesave individuale, kolektive, profesionale ose publike si dhe adreson kriteret mbi konfliktin e interesit, të cilat duhet të përcaktohen në rregulloren e brendshme të GVV-ve.

Në nenin 14, përcaktohet se GVV-të duhet të plotësojnë kriteret e akreditimit, që të mund të ushtrojnë funksionet sipas këtij ligji, kriteret të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, nëpërmjet urdhërit të Ministrit do të përcaktohet struktura e Ministrisë që do të jetë përgjegjëse për akreditimin dhe regjistrimin e GVV-ve.

Në nenin 15, përcaktohet se struktura përgjegjëse e ministrisë që do të ngihet me urdhër të ministrit (e përmendur në nenin 14 të këtij projekt ligji), krijon dhe administron regjistrin e GVV-ve, duke specifikuar të dhënat që duhet të përmbajë ky regjistër.

Nenin 16, përcakton se monitorimi dhe vlerësimi në baza vjetore, i aktivitetit të GVV-ve dhe përmbushja nga ana e tyre e standardeve të këtij ligji, realizohet

nga struktura përgjegjëse në Ministri, e cila ofron dhe sugjerime kur i konsideron të nevojshme.

Neni 17, përcakton nxjerrjen e akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji si dhe nxjerrjen e akteve nënligjore nga Ministri.

Neni 18, përcakton hyrjen në fuqi të këtij ligji, 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet e ngarkuara për zbatimin e këtij projektligji janë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin e ministrit nr. 151 datë 6.4.2018 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e projektligjit mbi zbatimin e qasjes LEADER dhe ngritjen e grupeve vendore të veprimit”. Grupi i punës është mbështetur nga eksperti ndërkombëtar Dr. Carlo Ricci dhe eksperti z. Florian Xhafa, me mbështetjen e Kooperacionit Italian.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji i propozuar nuk mbart efekte financiare për buxhetin e shtetit.

MINISTRI

Niko Peleshi

Grupi i punës

Enea Hoti
Grigor Gjeçi
Anxhelina Zhidro
Festim Shytaj